



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstva za Obrazovanje
Nauku, Tehnologiju i Inovacija-Ministry of Education Science, Technology and Innovation*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B/337

Datë: 01/12/2021

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1.19 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 17, 16 shtator 2011), nenit 8 paragrafit 1, nënparagrafit 1.4, nenit 14 paragrafit 1 nënparagrafit 1.7, shtojcës 1 pikës 7 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe nenit 10 paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ nr. 03/2013, dt. 16.05.2013), nxjerr:

VENDIM

Për përcaktimin e rregullave, kriterëve, kërkesave dhe procedurave për zbatimin e Programit për mbështetjen e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese

1. Programi për mbështetjen e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese realizohet përmes dy nënprogrameve:

- 1.1. Nënprogrami “Shpërblime për mësimdhënie të bazuar në punë hulumtuese”;
- 1.2. Nënprogrami “Grante për realizimin e projekteve të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese” .

2. Shpërblimi për mësimdhënie të bazuar në punë hulumtuese:

- 2.1. I jepet mësimdhënësit që ka krijuar ose pilotuar me sukses praktika të mira të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese në një lëndë ose grup lëndësh;
- 2.2. Shpërblimi nga pika 2.1 mund t’i jepet edhe grupit të mësimdhënësve që kanë punuar bashkë në realizimin e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese;
- 2.3. Shpërblimi jepet në bazë të aplikimit individual ose grupor në konkurs të hapur për të arriturat në pesë vitet e fundit (ex-post);
- 2.4. Shuma e shpërblimit është fikse - 1,500 € dhe mund të shfrytëzohet sipas preferencave të përfituesit;
- 2.5. Në rast të aplikimit grupor, shpërblimi ndahet në mes të aplikuesve, sipas kërkesës së tyre;
- 2.6. Shpërblimi nga pika 2.1 nuk mund t’i ndahet aplikuesit, i cili ka përfituar nga granti për realizimin e projektit për mësimdhënie të bazuar në punë hulumtuese.

3. Granti për realizimin e projektit për mësimdhënie të bazuar në punë hulumtuese:

- 3.1 Granti për realizimin e projektit për mësimdhënie të bazuar në punë hulumtuese, i jepet mësimdhënësit për mbështetjen e ideve për mësimdhënie të bazuar në punë hulumtuese, në mënyrë që të avancohet procesi mësimor në institucionin e arsimit të lartë ku mësimdhënësi punon;
- 3.2 Granti nga pika 3.1 mund t'i jepet edhe grupit të mësimdhënësve që do të punojnë bashkë në realizimin e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese (ex-ante);
- 3.3 Granti jepet në bazë të aplikimit individual ose grupor në konkurs të hapur;
- 3.4 Shuma maksimale e grantit është 6,000 €, ku të paktën 50% e grantit duhet të shfrytëzohet për mbulimin e shpenzimeve direkt të hulumtimit;
- 3.5 Në rast të aplikimit grupor, aplikuesit duhet ta përcaktojnë grantmbajtësin.

4. Hapja e konkursit

- 4.1. Ministria e përgatitë konkursin publik për Programin për mbështetjen e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese.
- 4.2. Konkursi publikohet në uebfaqen e Ministrisë dhe përmban:
 - 4.2.1. Ftesën publike për aplikime me informatë të përmbledhur për programin, afatet dhe mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve;
 - 4.2.2. Udhëzuesin për aplikues me udhëzime të plota për përshtatshmërinë e aplikuesve, mënyrën e përgatitjes së aplikacioneve, dokumentet e nevojshme për aplikim, mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve, seancat informuese dhe mënyrën e ofrimit të sqarimeve, afatet për realizimin e konkursit, informatat për vlerësimin e aplikacioneve dhe informatat tjera relevante për procesin e aplikimit;
 - 4.2.3. Formularët e aplikimit;
 - 4.2.4. Konkursi dhe të gjitha dokumentet përcjellëse përgatiten dhe publikohen në gjuhën angleze. Ministria mund të vendosë që disa dokumente të karakterit informues t'i publikojë edhe në gjuhën shqipe dhe serbe.
 - 4.2.5. Ministria e përgatitë edhe Udhëzuesin për vlerësim, i cili përcakton kriteret dhe procedurat e vlerësimit të aplikacioneve dhe marrjes së vendimeve për shpërblimet/grantet.
 - 4.2.6. Vendimi për shpalljen e konkursit, përfshirë aprovimin e dokumenteve, merret nga Këshilli Shkencor.
 - 4.2.7. Ministria mund ta publikojë njoftimin paraprak për konkursin, jo më shumë se tre muaj para datës së supozuar të publikimit të konkursit. Njoftimi paraprak publikohet në uebfaqen e Ministrisë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

5. Kushtet për aplikim

- 5.1. Të drejtën për aplikim në konkurs e ka secili mësimdhënës në marrëdhënie të rregullt pune në një institucion të arsimit të lartë, respektivisht grup i mësimdhënësve në marrëdhënie të rregullt pune në institucionin e njëjtë të arsimit të lartë.
- 5.2. Në rast të aplikimit në grup, njëri nga anëtarët e grupit caktohet si person kontakti për aplikacionin.
- 5.3. Një aplikues nuk ka të drejtë të dorëzojë më shumë se një aplikacion në një konkurs, qoftë si individ ose anëtar i grupit të aplikuesve.
- 5.4. Aplikacioni duhet të ketë mbështetjen e institucionit të arsimit të lartë ku është i punësuar aplikuesi ose grupi i aplikuesve.
- 5.5. Nuk kanë të drejtë aplikimi:
 - 5.5.1.1. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës;

- 5.5.1.2. Anëtarët e Këshillit Shkencor dhe këshillave të fushave shkencore të Ministrisë;
 - 5.5.1.3. Anëtarët e Jurisë së Programit për mbështetjen e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese;
 - 5.5.1.4. Anëtarët e bordeve, rektorët dhe prorektorët e universiteteve publike.
- 5.6. Me konkurs mund të përcaktohen edhe kushte shtesë për aplikim.

6. Dokumentet e nevojshme për aplikim në Programin për mbështetjen e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese janë:

- 6.1. Formulari i aplikimit i plotësuar sipas udhëzimeve të dhëna në “Udhëzuesin për aplikues” dhe i nënshkruar nga aplikuesi dhe personi i autorizuar i institucionit ku është i punësuar aplikuesi;
- 6.2. Në rast të aplikimit në grup, formularit për aplikim i bashkëngjiten autorizimet e aplikuesve për përfaqësim nga bartësi i aplikimit;
- 6.3. Dokumentet tjera mbështetëse të përcaktuara me “Udhëzuesin për aplikues”.

7. Aplikacionet dorëzohen brenda afatit dhe në mënyrën e përcaktuar me “Udhëzuesin për aplikues”

- 7.1. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

8. Juria e programit

- 8.1. Ministria emëron jurinë e Programit të përbërë prej dy anëtarëve vendorë dhe një anëtari ndërkombëtar.
- 8.2. Juria është përgjegjëse për vlerësimin e aplikacioneve në përputhje me dispozitat e këtij vendimi dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
- 8.3. Anëtarët e jurisë duhet të kenë përvojë të paktën 10-vjeçare të mësimdhënies në arsimin e lartë dhe të jenë njohës të mirë të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese.
- 8.4. Juria zgjedh kryesuesin nga radhët e anëtarëve të vet.
- 8.5. Anëtarët e jurisë do të kompensohen për punën e vet, ndërsa për anëtarin ndërkombëtar do të mbulohen edhe shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit.
- 8.6. Ministria do t'i ofrojë mbështetje të plotë administrative jurisë gjatë procesit të vlerësimit.

9. Vlerësues i aplikacioneve në kuadër të Programit për mbështetjen e mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese mund të jetë personi që i plotëson këto kushte:

- 9.1. Ka përvojë të paktën 5-vjeçare të mësimdhënies në arsimin e lartë në kontekst ndërkombëtar;
- 9.2. Ka përvojë të dëshmuar të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese;
- 9.3. Flet dhe shkruan rrjedhshëm gjuhën angleze;
- 9.4. Nuk është i punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;
- 9.5. Juria krijon një listë të vlerësuesve në bazë të fushës së mësimdhënies dhe punës hulumtuese dhe do të kompensohen në bazë të legjislacionit në fuqi.

10. Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve

- 10.1. Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve të dorëzuara bëhet për të verifikuar plotësimin e kushteve formale të përcaktuara me konkurs.
- 10.2. Shqyrtimi nga pika 1 bëhet nga zyrtari kompetent i Ministrisë dhe kryesuesi i jurisë ose nga një anëtar i Jurisë që e përfaqëson kryesuesin.

- 10.3. Për secilin aplikacion të dorëzuar shqyrtohet nëse janë plotësuar kushtet vijuese:
- Secili aplikues i plotëson kushtet nga pika 5 e këtij Vendimi;
 - Dokumentacioni është i plotë dhe i përgatitur konform pikës 6 të këtij Vendimi;
 - Dokumentacioni është dorëzuar brenda afatit të konkursit konform pikës 7 të këtij Vendimi.
- 10.4. Në rast të mosplotësimit të njërit nga kushtet nga nënpika 10.3 e këtij vendimi, aplikacioni refuzohet.
- 10.6 Në rast se një aplikues ka dorëzuar më shumë se një aplikacion në konkurs, qoftë si individ ose anëtar i grupit të aplikuesve, në kundërshtim me pikën 5.3 të këtij Vendimi, të gjitha ato aplikacione refuzohen.
- 10.5. Për secilin aplikacion do të plotësohet lista kontrolluese, e cila nënshkruhet nga zyrtari kompetent i Ministrisë dhe kryesuesi i jurisë ose anëtar i saj që e përfaqëson kryesuesin në procesin e shqyrtimit administrativ.
- 10.6. Të gjithë aplikuesve do t'u dërgohen njoftime të veçanta për rezultatin e shqyrtimit administrativ, sipas formatit të përcaktuar.
- 10.7. Me rezultatin e shqyrtimit administrativ do të njoftohen të gjithë anëtarët e jurisë.

11. Kriteret për vlerësim

- 11.1. Aplikacioni për nënprogramin “Shpërblime për mësimdhënie të bazuar në punë hulumtuese” do të vlerësohet me më së shumti 50 pikë, sipas kriterëve vijuese:
- 11.1.1. Cilësia e zbatimit dhe planifikimit të aktivitetit të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese – deri në 10 pikë;
- 11.1.2. Shkalla dhe cilësia e përfshirjes së studentëve në punë hulumtuese gjatë realizimit të aktivitetit – deri në 10 pikë;
- 11.1.3. Zbatimi praktik i njohurive të fituara nga ana e studentëve ose ndërveprimi aktiv me problemet shoqërore dhe/ose ekonomike – deri në 10 pikë;
- 11.1.4. Replikimi i aktivitetit ose potenciali për replikim në të ardhmen – deri në 5 pikë;
- 11.1.5. Bashkëpunimi me kolegë gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktivitetit – deri në 5 pikë;
- 11.1.6. Prania e aspekteve gjinore apo diversitetit kulturor gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktivitetit – deri në 5 pikë;
- 11.1.7. Udhëheqja e aktivitetit nga stafi akademik më i ri se 40 vjet, i gjinisë femërore apo nga komunitete tradicionalisht më pak të përfaqësuara –5 pikë.
- 11.2. Aplikacioni për nënprogramin “Grante për realizimin e projekteve të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese”, do të vlerësohet me më së shumti 60 pikë sipas kriterëve vijuese:
- 11.2.1. Cilësia, koherenca dhe realizueshmëria e aktiviteteve të planifikuara të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese – deri në 15 pikë;
- 11.2.2. Shkalla dhe cilësia e përfshirjes së studentëve në punë hulumtuese gjatë realizimit të aktivitetit – deri në 10 pikë;
- 11.2.3. Mundësia për zbatim praktik të njohurive të fituara nga ana e studentëve ose për ndërveprim aktiv me problemet shoqërore dhe/ose ekonomike- deri në 10 pikë;
- 11.2.4. Qëndrueshmëria - potenciali për replikim në të ardhmen – deri në 10 pikë;
- 11.2.5. Bashkëpunimi me kolegë gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktivitetit – deri në 5 pikë;
- 11.2.6. Prania e aspekteve gjinore apo diversitetit kulturor gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktivitetit – deri në 5 pikë;
- 11.2.7. Udhëheqja e aktivitetit nga stafi akademik më i ri se 40 vjet, i gjinisë femërore apo nga komunitetet tradicionalisht më pak të përfaqësuara – 5 pikë.

12. Procedura e vlerësimit

12.1. Për secilin nënprogram nga pika 1 e këtij Vendimi, juria cakton nga dy vlerësues të të gjitha aplikacioneve të atij nënprogrami që e kanë kaluar shqyrtimin administrativ nga pika 10 e këtij Vendimi.

12.2. Përveç vlerësuesve nga pika 12.1 e këtij Vendimi, për secilin aplikacion që e ka kaluar shqyrtimin administrativ nga pika 1 e këtij Vendimi, juria cakton edhe një vlerësues nga fusha shkencore e afërt me fushën e aplikuesit.

12.3. Vlerësuesit punojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, në bazë të “Udhëzuesit për vlerësim” dhe duke i shfrytëzuar formularët përkatës të vlerësimit.

12.4. Secili vlerësues, brenda afatit të caktuar, e harton raportin e vlerësimit për aplikacionet të cilat ka obligim t'i vlerësojë. Përveç pikëve dhe arsytimit të vlerësimit për secilin kriter nga pika 11 e këtij Vendimi, raporti përmban edhe komentet dhe sugjerimet eventuale të vlerësuesit në lidhje me trajtimin e mëtutjeshëm të aplikacionit, përfshirë sugjerimet për ndryshime në projekt dhe në buxhetin e projektit.

12.5. Zyrtari kompetent i Ministrisë, në bazë të raporteve të vlerësimit të aplikacioneve, harton dy tabela përmbledhëse, nga një për secilin nënprogram, duke i radhitur aplikacionet sipas numrit total të pikëve të dhëna nga vlerësuesit, e në përputhje me formatin e përcaktuar në “Udhëzuesin për vlerësim”.

12.6. Raportet e vlerësimit të aplikacioneve bashkë me tabelat përmbledhëse u dërgohen anëtarëve të jurisë.

12.7. Juria mban takim për shqyrtimin e raporteve të vlerësimit të aplikacioneve.

12.8. Gjatë procesit të vlerësimit, për secilin nënprogram, juria ndjekë këta hapa:

12.8.1. Shqyrtohen një nga një raportet e vlerësimit për aplikacione, me të drejtë korrigjimi të pikëve sipas kushteve vijuese:

12.8.1.1. Korrigjimi mund të bëhet duke shtuar ose zbritur pikë në shumën totale të pikëve për kriteret të veçanta të vlerësimit nga pika 11 e këtij Vendimi, nëse dallimi në mes të vlerësimeve të paktën dy vlerësuesve për kriterin gjegjës është më i madh se 50% e numrit maksimal të pikëve që parashihen për atë kriter;

12.8.1.2. Nëse për një kriter plotësohet kushti i pikës 12.8.1.1, atëherë shumës totale të pikëve për atë kriter mund t'i shtohen ose zbriten më së shumti aq pikë sa është diferenca maksimale në mes të pikëve të dy vlerësuesve të aplikacionit përkatës;

Shembull: Nëse për kriterin nga pika 11.2.1, vlerësuesi i parë i ka dhënë 4 pikë, vlerësuesi i dytë – 7 pikë, ndërsa vlerësuesi i tretë – 12 pikë, atëherë ekziston dallimi prej 8 pikësh në mes të vlerësuesit të parë dhe të tretë që përbën më shumë se 50% të numrit maksimal të pikëve që parashihen për kriterin përkatës (15 pikë). Në këtë rast, juria ka të drejtë ta bëjë korrigjimin e shumës së pikëve të tre vlerësuesve (4+7+12=23 pikë) duke shtuar ose zbritur deri në 8 pikë.

12.8.1.3. Çdo korrigjim i kësaj natyre duhet të evidentohet dhe të arsyetohet nga juria. Përcaktohet radhitja përfundimtare e aplikacioneve të vlerësuara sipas numrit total të pikëve, duke marrë parasysh korrigjimet e bëra.

12.9. Aplikacionet që kanë fituar më pak se 40% të trefshit të pikëve maksimale nga pika 11 e këtij Vendimi, refuzohen.

12.10. Duke u bazuar në radhitjen përfundimtare, juria përcakton aplikacionet fituese në bazë të fondit në dispozicion për nënprogramin përkatës.

12.11. Juria mund ta hartojë listën rezervë në të cilën përfshihen më së shumti dy aplikacione me më pak pikë se aplikacionet fituese, por me më shumë se 50% e trefshit të pikëve maksimale nga pika 11 e këtij Vendimi, duke respektuar radhitjen nga pika 12.8.1.3 e këtij Vendimi.

12.12. Për secilin aplikacion jofitues, hartohet një njoftim me arsyetimin për shkaqet e refuzimit.

12.13. Për secilin aplikacion fitues dhe nga lista rezervë hartohet një njoftim, i cili mund të përmbajë edhe kërkesa për ndryshime në projektpropozim, përfshirë edhe buxhetin.

12.14. Juria harton një raport përfundimtar për procesin e konkursit, të cilit i bashkëngjiten listat e aplikacioneve me vlerësime përfundimtare dhe vendimet e jurisë.

13. Marrja e vendimit për aplikuesit e suksesshëm

13.1. Raporti përfundimtar i jurisë aprovohet nga Këshilli Shkencor.

13.2. Vendimin përfundimtar për aplikuesit e suksesshëm, e merr Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë me rekomandimin e Këshillit Shkencor.

14. Njoftimi i aplikuesve dhe bërja e korrigjimeve

14.1. Të gjithë aplikuesve u dërgohen njoftimet e përgatitura nga juria.

14.2. Nëse njoftimet për aplikacione fituese dhe nga lista rezervë përmbajnë kërkesa për plotësimin dhe ndryshimin e projektpropozimit dhe/ose buxhetit, aplikuesve u jepet afat prej 10 deri në 15 ditë për t'i realizuar plotësimin dhe ndryshimin e kërkuar. Juria vlerëson plotësimin dhe ndryshimin.

14.3. Nëse korrigjimet nuk bëhen brenda afatit ose nuk bëhen në formë të kënaqshme për jurinë, Sekretari i përgjithshëm mund të nxjerrë vendim për refuzimin e aplikacioneve të tilla.

15. Nënshkrimi i marrëveshjes

Ministria dhe pala përfituese e nënprogramit të granteve për realizimin e projekteve të mësimdhënies së bazuar në punë hulumtuese lidhin marrëveshje me të cilën përcaktohen obligimet e ndërsjella.

16. Aplikuesit e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit në Komisionin e Ankesave të Ministrisë.

